

“Proper Pizza Albania”, Sh.p.k

NIPT L42209009E

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015**

**PASQYRAT E POZICIONIT FINANCIAR
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015**

AKTIVET	Shenime	31.12.2015	31.12.2014
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale		14,962,464	
Aktive afatgjata jomateriale		3,500,000	
Kerkesa te arketueshme		7,930,300	15,406,300
Totali i aktiveve afatgjata		18,462,464	15,406,300
Aktive afatshkurtera			
Kerkesa te arketueshme			
Kerkesa te tjera te arketueshme			
Inventari		2,868,226	
Parapagime dhe shpenzime te shtyra		4,565,648	629,508
Mjete monetare		846,978	396,351
Aktive totale afatshkurtera		8,280,852	1,025,859
TOTALI I AKTIVEVE		26,743,316	16,432,159
PASIVET DHE KAPITALI			
Kapitali			
Kapitali aksioner		19,214,300	19,214,300
Rezerva te konvertimit te monedhes se huaj			
Rezultati i mbartur		(2,782,141)	
Rezultati i ushtrimit		(15,155,467)	(2,782,141)
Totali i kapitalit		1,276,693	16,432,159
Pasive afatgjata			
Huate		3,006,743	
Provizione Afatgjata			
Totali i pasiveve afatgjata		3,006,743	--
Pasive afatshkurtera			
Huate			
Te pagueshme ndaj furnitoreve		16,580,034	
Detyrime ndaj Personelit		3,101,444	
Detyrime Tatimore		1,726,588	
Provizione afatshkurtra		2,328,507	
Totali i pasiveve afatshkurtera		23,736,573	--
TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		26,743,316	16,432,159

Proper Pizza Albania sh.p.k
Shenime per Pasqyrat Financiare te mbyllura ne 31 Dhjetor 2015

Proper Pizza Albania, sh.p.k
 PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE
 PER PERIUDHEN JANAR MAJ 2015

Pershkrimi	Shenime	Jan - Maj 2015	31.12.2014
Shitje		13,270,813	0
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit			
Mallra, lendet e para dhe sherbimet		-6,250,526	
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfryt		-6,426,000	(2,686,705)
Shpenzimet e personelit		-1,867,202	-95,436
Pagat		-1,606,552	(66,000)
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore		-260,650	(29,436)
Te tjera		-404,187	
Amortizimi dhe Zhvleresimet		-37,360	
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		-1,714,462	-2,782,141
Te ardhura dhe shpenzime financiare			
Te ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi		0	
Fitimi dhe humbje nga kursi i kembimit		0	
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare		0	
Fitimi (humbja) para tatimit		-1,714,462	-2,782,141
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		84,729	
Fitim (humbje) neto e vitit financiar		-1,799,191	-2,782,141

Proper Pizza Albania sh.p.k
Shenime per Pasqyrat Financiare te mbyllura ne 31 Dhjetor 2015

Proper Pizza Albania, sh.p.k
 PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE
 PER PERIUDHEN QERSHOR DHJETOR 2015

Pershkrimi	Shenime	31.12.2015	31.12.2014
Shitje		66,028,535	
Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit		-	
Mallra, lendet e para dhe sherbimet		31,498,067	
Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfryt		25,346,567	-2,686,705
Shpenzimet e personelit		21,400,282	-95,436
Pagat		-18,337,667	(66,000)
Shpenzimet e sigurimeve shoqerore		-3,062,615	(29,436)
Amortizimi dhe Zhvleresimet		-993,437	
Fitimi (humbja) nga veprimtarite e shfrytezimit		-13,209,818	-2,782,141
Te ardhura dhe shpenzime financiare			
Te ardhura dhe shpenzime financiare nga interesi		-146,458	
Fitimi dhe humbje nga kursi i kembimit		0	
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare		-146,458	
Fitimi (humbja) para tatimit		-13,356,276	-2,782,141
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin			
Fitim (humbje) neto e vitit financiar		-13,356,276	-2,782,141

Proper Pizza Albania sh.p.k

Shenime per Pasqyrat Financiare te mbyllura ne 31 Dhjetor 2015

Proper Pizza Albania, sh.p.k
PASQYRA E FLUKSITE TE PARASE E KONSOLIDUAR
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015

Pershkrimi	<i>Ne leke</i> 31.12.2015	<i>Ne leke</i> 31.12.2014
Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytezimit		
	(15,070,738)	(2,782,141)
Fitimi para tatimit		
Rregullime per:		
Shpenzime per interesa te njohura ne PASH		
Provizione te tjera		
Amortizimi I Aktiveve Afat gjate	1,030,797	
Te ardhura (Humbje) nga kembimet valutore		
Ndryshimet ne Flukset e MM nga aktiviteti I shfrytezimit	(14,039,941)	(2,782,141)
Rritje/renie e kerkesave te arketueshme		
Rritje/renie e tepricave te inventarit	(2,868,226)	
Rritje/renie ne shpenzimet e shtyra	(7,042,025)	629,508
Rritje/renie ne llogarite e furnitoreve	23,136,238	
Rritje/renie ne parapagime te ardhura te shtyra		
Interes I paguar		
MM Neto nga aktivitetet e shfrytezimit	(813,954)	629,508
Fluksi monetar nga veprimtaria e investimit		
Interes I arketuar		
Pagesa per blerje AAM	(9,218,163)	
Arketime nga kapitali I pronareve	7,476,000	3,808,000
MM Neto nga aktiviteti i investimit	(1,742,163)	
Fluksi monetar nga veprimtaria e financiare		
Rritje/renie ne llogarite e kerkesave per arketim afat gjate		
Rritje/renie ne huamarrje afat gjate	3,006,743	
MM Neto nga aktiviteti financiar	3,006,743	396,351
Diference konvertimi MM te mbajtura ne monedhe te huaj		
Rritja /renia neto e mjeteve monetare	450,627	396,351
Paraja dhe ekuivalenteve te saj ne fillim te vitit	396,351	0
Paraja dhe ekuivalenteve te saj ne fund te vitit	846,978	396,351

Proper Pizza Albania sh.p.k
Shenime per Pasqyrat Financiare te mbyllura ne 31 Dhjetor 2015

Proper Pizza Albania SHPK
PASQYURA E LEVIZJES SE KAPITALEVE
PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2015

Pershkrimi	Kapitali aksionar që i përket aksionerëve të shoqërisë					Totali
	Kapitali aksionar	Rezerva Statutore e Ligjore	Rezerva te konvertimit te MH	Fitimi I pashperndare	Fitimi I periudhes	
Pozicioni më 1 janar 2014	-	-	-	-	-	-
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabel	-	-	-	-	-	-
Pozicioni i rregulluar	-	-	-	-	-	-
Fitimi neto i vitit financiar	-	-	-	2,782,141	2,782,141	2,782,141
Kapitalit aksionar	19,214,300	-	-	-	-	19,214,300
Kalim I fitimi I periudhes se meparshme ne fitime te pashperndara	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2014	19,214,300	-	-	2,782,141	2,782,141	16,432,159
Fitimi neto i vitit financiar	-	-	-	-15,155,467	-15,155,467	-15,155,467
Emetim i kapitalit aksionar	-	-	-	-	-	-
Kalim I fitimi I periudhes se meparshme ne fitime te pashperndara	-	-	-	2,782,141	2,782,141	-
Pozicioni më 31 dhjetor 2015	19,214,300	-	-	2,782,141	-15,155,467	1,276,693

Pasqyrat financiare u firmosen dhe aprovuan në 31 Mars 2016.

Andon Hidersha
Administrator

Nek Consulting



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. Të dhëna të përgjithshme mbi Shoqërinë

Shoqëria Proper Pizza Albania sh.p.k është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në 03 Tetor 2014 dhe e regjistruar në datën 09 Tetor 2014 pranë Qendrës Nderkombëtare të Regjistrimit Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", nga statuti i saj dhe nga legjislacioni në fuqi.

Shoqëria zotërohet nga tre ortakë, Znj. Elvana Gjata me 35% të kuotave dhe Z. Andon Hidersha me 14% të kuotave dhe M.I.A me 51% të kuotave. Administratori i shoqërisë është Z. Andon Hidersha. Kapitali i shoqërisë sipas aktit të themelit është 19,214,300 lek.

Objekti kryesor i veprimtarisë së saj është prodhim dhe shitje produktet fast food të markës Proper Pizza.

Adresa e shoqërisë është Rruga "Gjin Bue Shpati", Tiranë. Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Drejtorinë Rajonale Tiranë me NUIS L42209009E.

Gjatë vitit kompania e ka filluar aktivitetin si një biznes subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, ndërsa në Qërshor për arsye të kalimit të xhiros mbi nivelet e subjekteve të biznesit të vogel, ka kaluar si subjekt i tatim fitimit.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015 u miratuan nga Administratori më 31 Mars 2016.

2. Baza e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

a. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me Rregulloren Shqiptare të Kontabilitetit, që përfshijnë rregullat dhe interpretimet në përputhje me ligjin Nr 9228 date 29 Prill 2004 "Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të shpallura në datë 15.06.2006.

Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

b. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të rasteve që përcaktohet ndryshe në shënimet në vijim.

c. Ndryshime ne metodat e vlerësimit kontabel

Efektet e ndryshimeve në vlerësimet kontabël janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të rasteve që përcaktohet ndryshe në shënimet në vijim.

d. Monedha Funktionale dhe me te cilen paraqiten pasqyrat

Pasqyrat Financiare paraqiten në monedhën vendase Lek (ALL), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë. Informacioni si në pasqyrat financiare ashtu dhe në shënimet e pasqyrave financiare është paraqitur në Lekë.

e. Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në vecanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Permbledhje e politikave dhe rregullave kryesore kontabël

Politikat kryesore kontabël të zbatuara nga shoqëria janë të përshkruara në vijim:

a. Veprimet ne monedha te huaja

Transaksioneve në monedhë të huaj regjistrohen në kontabilitet me kursin e datës së kryerjes së transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj janë përkthyer në pasqyrën e bilancit me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2015. Diferencat nga kursi i këmbimit të lindura nga perkthimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Asetet dhe detyrimet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Asetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj që paraqiten me vlerën e drejtë përkthehen me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është përcaktuar.

Kursi i këmbimit për dy monedhat e huaja kryesore me monedhën vendase sipas te Bankës së Shqipërisë me 31.12.2015, ka qënë respektivisht si më poshtë:

<u>Monedha</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
1 EUR	137.28	140.14
1 USD	125.79	115.23

b. Instrumenta financiar

Instrumentat financiarë jo-derivativë të shoqërisë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, likuiditete dhe vlera arke të tjera, hua të marra dhe të dhëna, dhe llogari të pagueshme.

i. Njohja fillestare dhe cregjistrimi

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Aktivitet financiarë cregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Detyrimet financiare cregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

ii. Njohja e mëtejshme

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturimi prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare. Likuiditetet dhe vlera arke te tjera maten më tej me koston e amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimet.

Huatë dhe Llogari të arkëtueshme

Huatë e dhëna dhe Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Llogaritë e arkëtueshme afatshkurtra nuk skontojnë.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv nëse është materiale.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë bankare dhe të tjera paraqiten me kosto të amortizueshme duke njohur cdo diferencë midis koston dhe vlerës së rikuperueshme në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huamarrjes në bazë të një interesi efektiv.

iii. Zhvlerësime të aktiveve financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo me shumë ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parasë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Vështirësitë e konsiderueshme financiare të debitorit, propabiliteti që debitori do të falimentoje apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arkëtueshme është e zhvlerësuar.

Aktivet e rendesishme financiare testohen në mënyrë individuale për zhvlerësim. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, mbi bazë grupesh që kanë karakteristika të ngjashme të riskut financiar.

Humbja nga zhvlerësimi lidhur me një aktiv financiar të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferenca midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit të aktivitetit. Vlera e një aktivi zvogëlohet nëpërmjet llogarisë për zhvlerësime dhe vlera e humbjes nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Nëse në një vit pasues, shuma e humbjeve të vlerësuar nga zhvlerësimi rritet apo ulët për shkak të një ngjarje pas njohjes fillestare të aktivitetit, humbja nga zhvlerësimi i njohur më parë rritet apo reduktohet duke rregulluar llogarinë e fondit rezervë të zhvlerësimeve. Nëse një aktiv i çregjistruar më parë, rikuperohet, ky rikuperim njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

iv. Zhvlerësimi i Aktivet jo-financiare

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

v. Përcaktimi i Vlerës së Drejtë

Vlera e drejtë e parasë dhe e likuiditeteve, llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme janë afërsisht të barabarta me vlerën kontabël të dhënë, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

vi. Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

vii. Kapitali aksioner

Kapitali aksioner njihet me vlerën nominale.

c. Inventari

Inventari paraqitet me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i përlllogaritur gjatë rrjedhës normale të biznesit, pa koston e përlllogaritur të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes. Kostot e inventarit janë përlllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dergimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

d. Investime në pjesëmarrje

Investimet në pjesëmarrje fillimisht njihen me kosto. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e pjesëmarrjes në fjalë.

e. Aktivet Afatgjata Materiale (AAM)

i. Njohja dhe matja

Në bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendodhjes së aktivitetit.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

Metoda per llogaritjen e amortizimit të ndërtesave dhe instalimeve teknike është metoda lineare e cila merr në konsideratë jetën e dobishme ekonomike, ndërsa amortizmi për AAM të tjera llogaritet mbi bazën e metodës zbritëse.

f. Aktivet afatgjata Jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale përfshijnë liçensat, të drejtat për përdorim dhe emri i mirë. Shoqëria nuk zotëron Aktike afatgjata jomateriale.

i. Njohja dhe Matja

Liçensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria si edhe emri i mirë paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar (shihni me poshtë) dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nese ka.

ii. Shpenzimet pasuese

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve të grupëzuara që nga data që janë të disponueshme për përdorim. Jetëgjatësia e parashikuar e aktiveve për periudhat aktuale dhe krahasuese është si më poshtë:

g. Të Ardhurat

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike, kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm vlerën e drejtë të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për tu marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të njësisë.

Të ardhurat nga shërbimet regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pamvarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës. Të ardhurat nga interesat regjistrohen në momentin e maturimit të tyre.

h. Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur mbi bazën e detyrimeve të konstatuara. Pagesat e kryera për qiranë si qira e zakonshme njihen si shpenzime të periudhës në bazë lineare duke u mbështetur në kushtet e qirasë.

i. Të Ardhurat dhe Shpenzimet Financiare

Të ardhurat financiare përmbledhin të ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara në banka, fitimet nga shitja e aktiveve financiare të mbajtura për shitje, si dhe fitimet nga këmbimet valutore. Të ardhurat nga interesi do të njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëhere kur përdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet për interesa nga huatë, humbjet nga këmbimet valutore si dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes do të njihen si shpenzime kur ato janë përlllogaritur me metodën e normës efektive të interesit.

j. Tatimi mbi Fitimin

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i prituri për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si edhe çfarëdolloj rregullimi kontabel te tatimit per t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15%. Gjatë vitit 2015 shoqëria ka rezultuar me humbje.

k. Zërat jashtë bilancit

Marrëveshjet e regjistruara jashtë bilancit pasqyrojnë kontratat (pa transferim parash) midis Shoqërisë dhe Institucioneve Financiare. Këto kontrata, në përgjithësi, janë për detyrime financiare ose garanci. Ato paraqesin detyrimin e Shoqërisë ndaj Bankës për të kryer detyrime gjatë ose deri në një periudhë të caktuar kohore. Këto marrëveshje regjistrohen kur detyrimi ka lindur. Vlera që regjistrohet në zërat jashtë bilancit korespondon me shumën e garantuar ose me vlerën e kontraktuar sipas marrëveshjes. Në datën e maturimit bëhet anulimi i veprimit.

Proper Pizza Albania sh.p.k
Shenime per Pasqyrat Financiare te mbyllura ne 31 Dhjetor 2015

1. Aktive Monetare

Përshkrimi	2015 ALL	2014 ALL
Para ne llogari rrjedhese	832,663	396,351
Para ne arke	14,315	0
Totali	846,978	396,351

2. Inventari

Përshkrimi	2015 ALL	2014 ALL
Inventari- Lende e pare	2,868,226	0
Totali	2,868,226	0

3. Aktive Afatgjata Materiale dhe Jomateriale

Lëvizja e Aktiveve Afatgjata Materiale paraqitet si më poshtë:

Pershkrimi	31.12.2014 ALL	Shtesa	Pakesime	31.12.2015 ALL
Kosto AAM				
Mjete transporti	-	3,416,473	-	3,416,473
Pajisje informatike	-	639,268	-	639,268
Te tjera ne shfrytezim	-	8,437,520	-	8,437,520
Totali		12,493,261		12,493,261
Amortizimi i akumuluar AAM				
Mjete transporti	-	310,588	-	310,588
Pajisje zyre e informatike	-	85,628	-	85,628
Te tjera ne shfrytezim	-	634,581	-	634,581
Totali		1,030,797		1,030,797
Vlera neto kontabel				
Mjete transporti	-	3,105,885	-	3,105,885
Pajisje zyre e informatike	-	553,640	-	553,640
Te tjera ne shfrytezim	-	7,802,939	-	7,802,939
Vlera neto kontabel		11,462,464		11,462,464

Kompania gjatë vitit ka bërë investime në aktive në vlerën 12,493,261 të cilat janë amortizuar sipas normave fiskale të lejuara.

Lëvizja e Aktiveve Afatgjata Jomateriale ku është përfshirë licenca franchise për të drejtën e tregtimit nën markën e Proper Pizza paraqitet si më poshtë:

Pershkrimi	31.12.2014 ALL	Shtesa	31.12.2015 ALL
Kosto AAJM	--		
Licenca	--	3,500,000	3,500,000
Software			
Amortizimi i akumuluar AAM			
Licenca	--	--	--
Software	--	--	--
Licenca	--	--	3,500,000
Software	--	--	--
Vlera neto kontabel	--	--	3,500,000

4. Kërkesa të tjera të arkëtueshme

Përshkrimi	2015 ALL	2014 ALL
Ortakët për kapitalin e padepozituar	7,930,300	15,406,300
Totali	7,930,300	15,406,300

Vlera e padepozituar e ortakëve nga kapitali I nënshkruar është paraqitur në këtë post.

5. Të pagueshme ndaj furnitorëve

Përshkrimi	2015 ALL	2014 ALL
Furnitore për furnizime	16,580,034	0
Totali	16,580,034	0

6. Detyrime ndaj personelit

Përshkrimi	2015 ALL	2014 ALL
Detyrime për paga muaji dhjetor	3,101,444	0
Totali	3,101,444	0

Proper Pizza Albania sh.p.k
Shenime per Pasqyrat Financiare te mbyllura ne 31 Dhjetor 2015

7. Detyrimet tatimore

Përshkrimi	2015 ALL	2014 ALL
Detyrime Sigurime +TAP	1,076,588	0
Detyrim per tatim ne Burim	49,665	0
Detyrimi per TVSH muaji dhjetor	600,335	0
Totali	1,726,588	0

Detyrimet tatimore në pasiv të bilancit paraqiten si më sipër. Në llogaritjen e tyre shoqëria ka mbajtur parasysh kërkesat e ligjit per TVSH-në, Tatimit mbi të Ardhurat, duke i pasqyruar këto tatime të rregjistruara drejt dhe të papaguara në 31 Dhjetor 2015.

8. Provizionet afatshkurtra

Përshkrimi	2015 ALL	2014 ALL
Provizione per shpenzime te pafaturuar	2,328,507	0
Totali	2,328,507	0

Në provizione janë përfshiorë detyrime për komisionin e licences franchise sipas kontratës.

9. Kapitali

Shoqëria ka një kapital themeltar prej 19,214,300 leke te ndarë ne 100 kuota. Ortaket e shoqërisë paraqiten si me poshte:

1. **M.I.A** zoteron 51% të kuotave
2. **Znj. Elvana Gjata** zoteron 35% të kuotave
3. **Z. Andon Hidersha** zotëron 14% të kuotave

Kapitali i shoqërisë nuk është depozituar i gjithi gjatë vitit 2015, gjatë vitit 2015 vetëm 11,284,000 Lekë është kapital i depozituar në shoqëri, ndërsa diferenca është pasqyruar te kërkesa të tjera të arkëtueshme.

10. Shitjet neto

Përshkrimi	2015 ALL	2014 ALL
Të ardhurat nga shitjet	66,028,535	0
Totali	66,028,535	0

Të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqërisë janë të njejta me ato të deklaruar në FDP.

Proper Pizza Albania sh.p.k
Shenime per Pasqyrat Financiare te mbyllura ne 31 Dhjetor 2015

11. Kosto e punes

Përshkrimi	2015 ALL	2014 ALL
Shpenzime per paga bruto	18,337,667	66,000
Shpenzime per sigurime	3,062,615	29,436
Totali	21,400,282	95,436

12. Shpenzime te Tjera

	2015 ALL	2014 ALL
Karburant	1,256,458	
Energji uje	1,939,436	
Shpenzime Udhetimi dhe Dieta	794,800	
Qira per parkim	54,440	
Sherbime Bankare	91,418	
Qera ambiente	2,524,906	
Mjet me qira	350,026	
Provizione per shpenzime	2,328,507	
Shpenzime pa fatura te rregullta fiskale	4,612,686	
Shpenzime per mirembajtje	4,573,034	
Shpenzime per kancelari	436,732	
Shpenzime per marketing	3,654,408	
Te tjera	5,283,549	2,686,705
Gjoba Penalitete	63,880	
Taksa Lokale e leje	578,181	
	25,346,567	- 2,686,705

13. Të ardhura dhe Shpenzime Financiare

Struktura e rezultatit financiar deri më 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

Përshkrimi	2015 ALL	2014 ALL
Shpenzime nga interesat	146,458	0
Totali	146,458	0

14. Llogaritja e Tatimit mbi Fitimin

Në percaktimin e rezultatit tatimor shoqëria ka marrë në konsideratë shpenzimet e panjohura për efekte fiskale. Ato lidhen më:

	<u>Dhjetor 31, 2015</u>	<u>Dhjetor 31, 2014</u>
<i>Fitimi/humbja para tatimit (qershor - dhjetor)</i>	(13,356,276)	(2,782,141)
Shpenzime te panjohura te tjera	14,561,865	
Sherbime pa dok. Te rregullta fiskale & Penalitete	12,169,478	
Provisione (Per fatura te pamberritura)	2,328,507	
Penalitete	63,880	
<i>Fitimi para tatimit (me shpenzimet e panjohura)</i>	1,205,590	(2,782,141)
<i>Fitimi/humbja para tatimit (Janar - Maj)</i>	(1,714,462)	
Shpenzime te panjohura (janar - maj)	2,844,187	
<i>Fitimi para tatimit (me shpenzimet e panjohura)</i>	1,129,725	
Humbje fiskale e (viti 2014)	(2,782,141)	
<i>Fitimi para tatimit (me shpenzimet e panjohura)</i>	(446,827)	
<i>Tatim fitimi si biznes l vogel</i>	84,729	
Fitim / Humbja	(15,155,467)	(2,782,141)

Për vitin 2015 shoqëria ka rezultuar me humbje.